



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15552 Prot.

Lezhë, më 31.08.2020

VENDIM

Nr. 122 Datë 26. 08. 2020

Për

**Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e shtetases Znj.Suela Pjeter Gjonaj, banore në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; të ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"; të VKM nr. 329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e pergatitur nga komisioni i ngritur, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Znj.Suela Pjeter Gjonaj, banore në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, pas diskutimit të anëtarëve, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetases Znj.Suela Pjeter Gjonaj për dëmtimin e banesës së saj nga rënia e zjarrit.

**A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në vlerën 121486 lekë.**

**a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë 121486 lekë.**

**b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 0 lekë.**

B. Mbështetur në VKM nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërma b e ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d, të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

**a) Vlera e Kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetë 60743 lekë.**

**b) Vlera e Kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje 0 lekë.**

**Vlera totale 60743 lekë.**

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhe t'i akordojë familjes së shtetases Znj.Suela Pjeter Gjonaj, ndihmën emergjente në vlerën prej 60743 lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2020, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012 për Emergjencat Civile.

4. Ndhma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetases Znj.Suela Pjeter Gjonaj, banesa e të cilës është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**

